

# **NOUNS' CASE SYSTEM OF ALBANIAN LANGUAGE ACCORDING TO KOLEC TOPALLI**

## **SISTEMI RASOR I EMRAVE TË SHQIPES SIPAS KOLEC TOPALLIT**

**Edona JAHIU<sup>1</sup>**

*<sup>1</sup>PhD Candidate in Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina“*

*\*Corresponding author e-mail: edona95@hotmail.com*

---

### **Përmbledhje**

Në këtë punim paraqitet qasja e Kolec Topallit ndaj formimit dhe zhvillimit të sistemit rasor të emrave në gjuhën shqipe, i cili është bazuar në arritjet shkencore të studiuesve paraprakë shqiptarë e të huaj. Ky sistem ka pësuar lëvizje të vazhdueshme, në një anë duke u tkurrur e reduktuar, por njëkohësisht, duke u zhvilluar me mbaresa të reja e të veçanta për gjuhën shqipe. Mungesa e dokumentimit të hershëm i ka shtyrë shumë albanologë të merren me këtë sistem, ta trajtojnë secili në mënyrën e vet, normalisht jo arbitrarisht, në përjasje me zhvillime fonetike, fjalë apo me forma, në shqipe e në gjuhët motra të saj. Topalli, mbështetur në të dhëna nga autorët e tjerë, për secilën rasë jep shpjegime, shoqëruar me shembuj konkretë.

Kështu, qëllimi ynë kryesor është ta japim gjykimin e Topallit rreth këtij sistemi, mënyrën e përfitimit të tij në gjendjen siç është sot, por edhe t'i përqasim pikëpamjet e tij me autorë të tjerë, si dhe të japim shpjegime individuale me anë të metodës analitike e interpretuese. Topalli, siç do ta shohim, sistemin rasor të shqipes e sheh me formante pjesërisht të trashëguara (disa të zgjeruara, të reduktuara apo të mënjanuara), pra, vetëm në disa raste i sheh si burimore, por larg formës bazë.

***Fjalët kyçe:** Kolec Topalli, sistemi rasor, shqipe, i trashëguar, i ri, i reduktuar.*

---

### **1. Hyrje**

Shqipja, si një gjuhë flektive, ka pësuar ndryshime e transformime të shumta gjatë një periudhe kohore të gjatë në të gjitha sistemet (diku më shumë e diku më pak), por fatkeqësisht, shumica e tyre nuk janë të dokumentura. E te sistemi rasor i emrave, të cilin do ta trajtojmë këtu, kjo bëhet më e komplikuar kur kemi parasysh praninë e paradigmës së lakimit të shquar dhe të pashquar. Ndryshimet fonetike të pësuar, theksi dinamik, fjalët shërbyese, prapavendosja e nyjës shquese e kanë bërë të dallueshëm sistemin e rasave me atë të gjuhëve simotra. Rrjedhimisht, si pasojë e këtyre faktorëve, kuptimet e tyre gramatikore shprehen me anë mbaresash të veçanta ose me forma të njëjtësuar (p.sh. kallëzorja me emëroren në trajtën e pashquar njëjës (një djalë), ose me nyjë (rasa gjinore). Qëndrimet më të njohura ndërlidhen me dy shpjegime kryesore: ka studiues që e shohin si të ri këtë sistem (Bokshi, Skoku etj.) dhe të trashëguar nga gjuha indoevropiane (Demiraj, Pedersen etj.).

Një prej studiuesve që ka bërë studim serioz për diferencimet formale të rasave, saktësisht ecurisë së zhvillimit të sistemit rasor të emrave nëpër kohë, është edhe Kolec Topalli. Ai, disa mbaresa i sheh të rëna e disa të reja, të cilat kanë mbushur zbrazëtitë e atyre që kanë rënë. E, në këtë punim do të përshkruhen dhe komentohen pikëpamjet e Topallit lidhur me sistemin rasor të emrave të shqipes në rrafsh diakronik. Aktiviteti i tij krijues dhe thellimi i punës nga brezat paraprakë kanë bërë që të sqarohen çështje me interes për historinë e shqipes.

Kontribut dhe ndihmesë të konsiderueshme në përgjithësi për morfologjinë e shqipes kanë dhënë edhe: Holger Pedersen, Gustav Mayeri, Aleksandër Xhuvani, Martin Camaj, Selman Riza, Kostaq Cipo, Mahir, Domi, Besim Bokshi, Eqrem Çabej etj. Kolec Topalli i sheh si të pazgjidhura plotësisht problemet më të rëndësishme që lidhen me sistemin rasor, por megjithatë, ai ka dhënë pikëpamjet e tij. Për t'u marrë me këtë fushë studimesh, i është dashur ta sigurojë literaturën shkencore në fushën e gjuhësisë historike indoevropiane e shqipe dhe të përvetësojë arritjet më të konsoliduara të shkencës albanologjike në këtë fushë, para se të marrë guximin të hedhë hapa konkretë në ngritjen e hipotezave.

Topalli ka dhënë leksione, ka referuar në shumë simpoziume e seminare ndërkombëtare dhe ka mbajtur konferenca shkencore për historinë e gjuhës shqipe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, si edhe në disa universitete e qendra shkencore jashtë vendit (Kozencë, Romë, Lecce, Palermo, Bari, Napoli, Mynhen, San-Peterburg, Detroit, Bukuresht, Zagreb, Glaskoë, Krakov, Riga etj.). Më 2015, ka hartuar një fjalor etimologjik, i cili është mbështetur në arritjet e gjuhësisë historike dhe në hulumtim të gjerë. Ka botuar vepra me karakter sintetik, shpjegues, të orientuara kryesisht në rrafshin tematik në historinë e gjuhës. Lidhur me atë që na intereson këtu, ka botuar këta libra: "Evolucioni historik i përemrave të shqipes" (2008), "Sistemi rasor i emrave të shqipes" (2009), "Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe" (2011), "Gramatikë historike e gjuhës shqipe" (2011).

## **2. Sistemi rasor i emrave të shqipes (2009)**

Sistemi emëror në shqipe, specifikisht ai rasor i emrave në shqipe, si ndër çështjet më të ndërlikuara të historisë së gjuhës shqipe, në rrjedhë të kohës, ka pasur zhvillime të veçanta nga gjuhët simotra. E si ndryshime paralele me gjuhë simotra shihen: pakësimi i numrit të rasave, lakimi i dyfishtë, përdorimi i nyjës joshquese etj. Me ndihmën e metodës krahasuese normalisht, si dhe me zhvillimin e fushave të tjera si etimologjia, morfologjia historike, e dialektologjia, por nuk përjashtohen edhe gjurmimet onomastike e filologjike, albanologët kanë arritur të ngritin hipoteza të caktuara lidhur me sistemin rasor të emrave.

Prirjen e shqipes për t'i dalluar rasat e shohim si domosdoshmëri morfologjike për ta diferencuar formalisht, ndër të tjera, edhe vlerën funksionale të emrave. Kjo i ka nxitur albanologët të hulumtojnë jo vetëm format e mbaresat, por edhe arsyet e zhvillimit, përgjithësimet të tyre dhe prirjet për t'i dalluar rasat nga njëra-tjetra. Libri i Topallit "Sistemi emëror i emrave të shqipes" (2009) jep një ndihmesë me shumë vlerë dhe shërben si bazë për studime më të gjera në trajtimin e prirjeve në paradigmën e sistemit emëror, specifikisht në sistemin rasor të emrave, në rrafsh diakronik. Në parathënien e librit, jepen disa konstatime për krijimin e një sistemi të ri të rasave, që largohet nga ai i vjetri.

Si shkak për këtë, Topalli me të drejtë e sheh theksin dinamik, që ka vepruar në zanoret e patheksuara që shërbenin si mbaresa, duke i rrëgjuar e zhdukur ato, gjë që ka çuar në krijimin e një sistemi të ri, për t'i shënuar kategoritë gramatikore të emrit me mbaresa të tjera. Normalisht, këto ndryshime janë çështje shekujsh, duke kaluar nga një tip sintetik, në sintetik-analitik, duke e pakësuar numrin e rasave, thjeshtuar mbaresat, e në krijimin e dy lakimeve (i shquar, i pashquar).

P.sh. edhe nyjat e prapme, siç është argumentuar nga Pedersen (1905), rrjedhin nga përemrat dëftorë, të cilët kanë qenë analitike, por tani ato janë bërë mjete sintetike, duke u përngjitur me emrin.<sup>31</sup> Disa dukuri të zhvilluara në sistemin rasor janë ballkanike (prapavendosja e nyjës shquese, njësimi i rasave gjinore-dhanore). Fillimisht, pas hyrjes, në këtë libër jepen sqarime rreth sistemit rasor indoevropian, i cili normalisht është krejt i rindërtuar bazuar në gjuhët që hyjnë në këtë familje. Ky sistem përbëhet nga 8 rasa: emërorja, thirrora, kallëzorja, gjinorja, dhanorja, rrjedhorja, vendorja, instrumentalja, që kanë pasur funksione të ndryshme, duke shprehur lidhjen e emrit me gjymtyrë të tjera. Shqipja, me besnikëri, i ka ruajtur pesë, kurse vendoren, instrumentalen, thirroren i ka hequr nga sistemi.

“Sistemi rasor i shqipes paraqitet krejtësisht i riorganizuar. Në të ka mbetur fare pak gjë nga sistemi i vjetër; madje, edhe nga mjetet e gjuhës indoevropiane që shërbenin për të dalluar rasat e ndryshme, shqipja ka ruajtur shumë pak. Por, për të zëvendësuar humbjet e ndjeshme me sistemin e vjetër, ajo ka krijuar mjete të reja, me të cilat, e ka reformuar sistemin rasor” (Topalli 2007:48). Pra, Topalli i sheh mbaresat pjesërisht të trashëguara dhe format e tanishme rasore krejtësisht të riformuara dhe të begatuara me mjete vetjake.

Për shumë studiues si Dozoni (1879), Skoku, (1926), Cimohovski (1951), sistemi rasor është dukuri relativisht e re në shqipe. Ngjashëm mendon edhe Bokshi (1980, 2010), sipas të cilit, sistemin e mbaresave, shqipja e ka bjerre qysh në kohën e kontakteve të para me greqishten e latinishten, duke thënë se përemri dëftor dhe nyja e përparme e kanë ruajtur dhe zhvilluar lakimin e vjetër, dukuri që i ka dhënë shkas rishfaqjes së lakimit, proces i cili, sipas tij, ka përfunduar para shek. VII. Por, Demiraj (2002:139-40) mendon se faktorët që i kanë dhënë shkas mënjanimin të lakimit tek emrat, në asnjë gjuhë nuk kanë mundur zhvillimin e një sistemi të ri rasor, e për më tepër, faktorët që i kanë dhënë shkas zhdukjes së lakimit tek emrat, duhej të kishin shkaktuar të njëjtën dukuri edhe te përemrat dëftorë dhe te nyjat.

Sipas tij, sistemi rasor i shqipes së dokumentuar është në thelb i trashëguar nga një fazë e hershme, por ka pësuar ndryshime gjatë shekujve. Sa i përket kësaj pjese, ne nuk mund të mbështesim me këmbëngulësi asnjërin pikëpamje, meqë të gjitha janë hipoteza rindërtimesh (normalisht jo arbitrare), sepse para shek. XV nuk kemi asnjë dokument nga shqipja, por duke pasur parasysh veprimin theksit dinamik, mund të anojmë më shumë nga mendimi i Bokshit. Rastet e lëvizjes së theksit, zhvendosjes së tij në prapashtesën e shumësit shihen si mbijetime të kohës kur ka pasur lëvizje theksi.

Përndryshe, në shqipe theksi bie gjithmonë në temë të fjalës, e jo në mbaresa. Shumicën e mbaresave, Topalli i sheh të rëna gjatë kohës dhe sipas tij, për mbaresat e reja, mjet ndihmës ka qenë nyja e prapme,<sup>32</sup> përcaktorët që janë të pranishëm te trajta e pashquar (*lojërat e këtyre djemve*), e që mungojnë në trajtën e shquar (*lojërat e djemve*). Ndryshimet e tjera në sistemin rasor përmbledhen, duke i vënë theksin sinkretizmit që ka vepruar në bashkimin ose njëjtësimin e rasave gjinore e dhanore dhe në rasat emërore e kallëzore të cilat i ka prekur vetëm në trajtën e pashquar (*e.një mal, k.një mal, em.disa male, k. disa male*) dhe të dyja trajtat e numrit shumës, por jo edhe në të shquarën të numrit njëjës (*mali-malin*). Kjo formë e fundit bën që të kundrohen si dy rasa. “Dy forma rasore u përkasin rasave të ndryshme, kur kanë forma të veçanta për secilën rasë” (fq. 52).

<sup>31</sup> Arsye për këtë përngjitje është edhe prirja e njohur e shqipes për prapavendosjen e përcaktorëve të pavetëmjafueshëm (djal-i), veti kjo e ngjashme me gjuhën tjetër ballkanike, rumanishten.

<sup>32</sup> Këtu duhet ta përmendim edhe mjetin analitik të rasës gjinore, nyjën e përparme i, e ,të ,së që shërben, dhe mendohet se e ka burimin në nevojën për ta dalluar gjinoren nga dhanorja.

Megjithatë, këto rasa dallohen jo vetëm nga forma në njëjësin e shquar që janë karakteristike për këto dy rasa, por edhe për nga funksioni sintaksor: emërorja zakonisht është në rol të kryefjalës, ndërsa kallëzorja të kundrënës. Dihet se brenda sistemit rasor të shqipes bëjnë pjesë 5 rasa, por Topalli e merr rasë më vete edhe kallëzoren parafjalore në *malt*, e cila ruhet në disa forma dialektore, por jo në normën standarde. Në pjesën ku shpjegon tingujt antihiatizues, konkretisht zanoren *j*, Topalli (fq.67), si përjashtime nga rastet: (*një luleje, muaji*<sup>33</sup>) i sheh rastet (*kroi ftoi*), duke thënë se ato mund të rikthehen në gjysmëzanore, duke formuar diftong me zanoren e rrënjës.

Por, në fakt, në këto raste nuk kemi diftong, por tog zanor, sepse këto zanore u takojnë rrokjeve të ndryshme: *kro-i*, derisa për t'u quajtur diftong, duhen qenë pjesë e së njëjtës rrokje. Ngjashëm me Demirajn, edhe Topalli e sheh njëjën joshqese me prejardheje nga numërori *një*. Për dallim nga Topalli (pjesërisht) dhe Bokshi (1980:8) që mendojnë se mbaresat e trashëguara kanë rënë fillimisht, Demiraj(2002) ndjek tjetër rrugë, duke i parë në thelb të trashëguara. Me këtë çështje, siç i citon edhe Topalli, janë marrë një sërë albanologësh shqiptarë e të huaj. Boppi e shihte këtë sistem si të trashëguar (p.sh. mbaresën *sh* e shihte të ardhur nga *sum* të indoevropianishtes), Pedersen (1894), v-në te mbaresa *-ve* e shihte si tingull antihiatizues, Jokli (1915) mbaresën *-om* e shihte të shndërruar në *ë*, që ruhet edhe sot në emrat e gjinisë mashkullore.

Selman Riza (1953, ribotuar më 2002), sistemin rasor dhe nyjat e shqipes i bëri objekt monografish të veçanta. Ai është përqendruar te rasat e drejta (emërore, kallëzore) dhe të zhdrejta, e në formimin e nyjave mashkullore. Gjithashtu edhe Bokshi (1984, 2010) ka bërë një vështrim sistemor të problemeve dhe ka arritur në përfundim se shqipja në një kohë kishte mbetur pa mbaresa. Këto të fundit, sipas tij, burojnë nga segmente brenda grupit emëror.

### 3. Paradigmat e lakimit

Sa u përket paradigmave të lakimit, në sistemin emëror të shqipes ekzistojnë disa modele mbështetëse për përcaktimin e llojit të lakimit, pra emrat nuk marrin mbaresat e njëjta në po të njëjtat rasa. P.sh. te lakimi i pashquar njëjës kemi prirje për thjeshtim të vazhdueshëm. Kemi vetëm mbaresat *-i* (një lisi), *-u* varësisht nga rrethimi fonetik dhe *-e*, *-je* (një vajze, një luleje). Në shqipe, siç e potencon edhe Topalli, (2009:72) në trajtë të pashquar, emrat e gjinive të ndryshme kanë rënë në emërues të përbashkët në shumë raste p.sh: me bashkëtingëllore, *gjysh. kumbull*, me *ë: djalë, vajzë*. Për këtë arsye, ndarja në katër lakime, për të mos shkakatuat paqartësi e pështjellim, është mbështetur në mbaresën e trajtës së shquar njëjës: Lakimi i parë me mbaresën *i*, i dyti me *u*, i treti me *a*, *ja*, i katërti me *t(ë)*.

Në lakimin e parë dhe të dytë, hyjnë emrat e gjinisë mashkullore. Ndarja në dy lakime është bërë për shkak të kushteve fonetike. Megjithëse të dyja klasat mbarojnë me bashkëtingëllore, ata që mbarojnë me grykoret *k*, *g*, *h*, marrin mbaresën shquese *u*, përderisa ata të lakimit të parë, kanë mbaresën shquese *i* në rasën emërore. “Një grup të veçantë në klasën e parë, formojnë emrat që dalin me lëngëzoret *ll*, *r*, meqenëse ata ndryshojnë zanoren e rrënjës: në të shquarën dalin me zanore të plotë: *kaprolli*, kurse në të pashquarën dalin me tog zanor *kapruall*” (fq. 80).

Pra, kur e kemi në të shquarën, për shkak të njëjës shquese, nuk mund të diftongohet zanorja, përderisa në të pashquarën ndodhet pranë një lëngëzoreje, që plotëson kushtet fonetike për diftongim. Por, meqë shqipja priret për thjeshtësim, tani edhe në të pashquarën përdoret zanorja e plotë (një kërcell-kërcelli, e jo kërcuell).

<sup>33</sup> Te fjala *muaji*, j-ja, pavarësisht se është shtuar më vonë si pasojë e bashkëndeshjes mes tri zanoresh, është pjesë e temës së fjalës, jo mbaresë.

Gjithashtu, Topalli i sheh si një grup të veçantë emrat që dikur kanë pasur një zanore hundore, por që ka rënë për shkak të pozicionit fundor në trajtën e pashquar, ndërsa në të shquarën është mbrojtur nga nyja shquese: *zan-zë-zëri*.

#### 4. Rasat e drejta (emërorja dhe kallëzorja)

Në pjesën e dytë të librit të Topallit "Sistemi emëror i gjuhës shqipe", trajtohen dy rasat e drejta, që janë njëjtësuar për nga forma në disa raste: emërorja dhe kallëzorja. Fillimisht, janë dhënë shpjegime për lakimin I dhe II, ku bëjnë pjesë emrat me temë më bashkëtingëllore (lis, mal), me zanore të theksuar (ka, mi, shi) dhe ata me *ë* tradicionale (gjumë, burrë, djalë). Mbështetur edhe në pikëpamjet e Pedersenit (1900), Meyerit, edhe Topalli (fq. 103) thotë se emrat me temë më bashkëtingëllore në gjuhën indoevropiane kanë pasur mbaresën -s (lupus), Por, kjo mbaresë ka rënë herët, sepse nuk do të ndiqej rruga e formimit të mbaresës së sotme.

Ndërsa, koha e rënies ose përcaktimi i kronologjisë së ndryshimit të mbaresës është çështje ndoshta e pazgjidhshme. "Trajta e shquar, që është formuar nga tema e emrit pa mbaresë, dëshmon se në kohën kur u formuan nyjat shquese, kjo mbaresë kishte rënë (Topalli 2009:103). Ai e lidh këtë kohë me periudhën parahistorike, para fillimit të marrëdhënieve gjuhësore me latinishten. Topalli (fq.107-118) jep edhe shembuj konkretë të emrave mashkullorë të të gjitha nëngrupeve, duke dhënë edhe sqarime plotësuese në lidhje me etimologjinë e tyre, sidomos në rastet kur tek autorët e vjetër paraqiten me *ë*: *kucedrë, mjekrë, gjarpënë*.

Pedersen (1905:209) ka hedhur një vështrim në lidhje me tingullin fundor *ë*, duke shënuar se është e vështirë të dallohet se prej cilave ligje fonetike një zanore fundore zhduket ose reduktohet në *ë* dhe sipas tij, një *o* dhe *ó* e gjatë ka lënë një *ë* në rrethana të caktuara konsonantike *kalë-caballos*. Megjithatë ky mendim nuk ka gjetur mbështetje, mendojmë se i shpjegon disa raste. Derisa emërorja e mashkullores kishte mbaresën *s*, në kallëzore kishte sonanten hundore *n < m*. "Mbaresa e rasës kallëzore -n është ruajtur në gjuhën shqipe së paku deri në kohën e formimit të nyjave, pasi vetëm me këtë, mund të shpjegohet formanti *në* i trajtës së shquar të kësaj rase, i formuar nga bashkimi i mbaresës *n* të kallëzores së pashquar me nyjën shquese" (fq. 129).

Kjo do të thotë se në lakimin e shquar, mbaresa -*në* e ka burimin tek ajo e vjetra e indoevropianishtes. Si dëshmi për këtë, ai jep shfaqjen e saj në trajtë të shquar, ndryshimin që ka pësuar përemri dëftor *atë, këtë*, që ka qenë pasojë e hundorësisë, emrat (*zan-zë-zërin*), përemrat (*tant-tëndin*). Sa i përket mendimit se "emrat mashkullorë me mbaresën *ë*, ku përfshihen edhe disa që kanë kaluar në gjininë femërore, janë forma të rasës kallëzore, që kanë kaluar në rasën emërore për hir të njësimi të këtyre dy rasave, kurse emrat me temë në bashkëtingëllore janë forma të rasës emërore që janë shtrirë edhe në kallëzore" ne pajtohemi pjesërisht, për shkak se mendojmë që *ë*-ja edhe tek ata me temë më bashkëtingëllore më shumë ka dalë në formë të njëjtë për shkak të prirjes për njëjtësim.

Si shembuj të kësaj prirjeje, mund të marrim edhe rrugën e disa emrave me temë më bashkëtingëllore që tek autorët e vjetër dalin si të gjinisë femërore: *shëndetja-shëndet, qytetja-qytet* etj, të cilët kanë marrë të gjitha karakteristikat e lakimit të parë. Lëvizja e brendshme mes dy këtyre rasave të drejta, siç e thotë edhe Topalli (fq. 144-146) nuk është kryer në mënyrë kaotike, por emërorja është treguar më e fuqishme, sepse me të mbetej dallimi i gjinive. D.m.th. shumica dërrmuese e emrave janë shtrirë prej emërores në kallëzore, por ka pasur edhe integritet nga kallëzorja në emërore, te temat me sonante *n* (*an on, en in*) *pjepën*, sonantet lëngëzore (*i vjetën - i vjetër*), sonantet anësore (*shekullë-shekull, engjëllë-engjëll*).

Këto tema shihen nga Topalli si të mbrojtura nga mbaresa e kallëzores, që ndryshe, do të çonte në rënie tingujsh ose në prishje të eptimit. Pra, ka pasur veprim të ndërsjellë mes rasash. Jokli (1915:120 cit. sipas Topallit 2009) si shembull për këtë raport rasor sjell format *hap* nga *hapë*, *plas* nga *plasë*, me format e tyre të zgjeruara: *fjetunë*, *hapunë*, *punue* – *punuar*. Sipas tij, forma geqe është trajtë e rasës emërore, kurse ajo toske e rasës kallëzore, mendim ky i kontestueshëm. Ne pajtohemi me mendimin e Topallit (fq.154), i cili thotë se kjo mbaresë “në toskërishte ka kaluar në *rë* me anë të rotacizmit dhe është prapashtesë e trashëguar e pjesores \**no*”.

Nyja shquese *-u*, sipas Pedersenit, ka qenë parësore, por ky mendim është kritikuar, sepse nyja *i* është më e konsoliduar në shqipe, meqë – u-ja shfaqet si nyjë e prapme vetëm në kushte të caktuara fonetike, pranë grykoreve *k g h* (ahu, miku, zogu) etj. Sa u përket emrave të lakimit të tretë, që përfshijnë emrat femërorë, është pranuar nga disa studiues se mbaresat e hershme të rasës emërore e kallëzore *a*, *am* kanë rënë në emërues të përbashkët *ë* dhe varësisht nga përbërja fonematike, marrin mbaresën *a* dhe *ja* në trajtën e shquar njëjës. Demiraj (2002:168) mendon se zanorja *e* fundore e emrave (lule, nuse) është relativisht e re në gjuhën shqipe, pra nuk mund të jetë e trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane, por është përftuar gjatë zhvillimit historik të shqipes.

Ndërsa, në rastet kur është formant shumësi, *e*-ja, siç thotë Topalli (196-197), mund të lidhet me një *-ia* të trashëguar, duke u krahasuar me shumësat e latinishtes. Ky formant është shtrirë edhe tek emrat mashkullorë, duke u dhënë atyre karakter femërorizues edhe në përcaktorët e tyre (male të larta). Këta quhen edhe emra ambigjenë, meqë e ndërrojnë gjininë në shumës. Nyja shquese e këtyre emrave, siç dihet, paraqitet në dy forma *a* tek emrat që në të pashquarën dalin me *ë* dhe *ja* tek emrat që dalin me temë më zanore. Burimin e *j*-së, pos si zanore antihiatizuese, Topalli e sheh edhe si zhvillim të grupit *li*: *golia*- *goja*.

## 5. Rasat e zhdrejta (gjinorja e dhanorja)

Në shqipe, këto dy rasa të zhdrejta marrin mbaresa të njëjta: *i*, *e vajzës*, *vajzës*, por dallohen në planin sintaksor e funksional: gjinorja ka të paraprirë nyjën e përparme, dhanorja jo. Ajo luan rolin e përcaktorit dhe gjithmonë paraprihet nga një emër, për dallim nga dhanorja që ka pozicion të lirë në fjali. Te rastet p.sh. në të pashquarën *një zëri*, *i*, *e një zëri*, forma është e njëjtë me atë të trajtës së shquar emërore : *zëri*. “Në këtë rast, mbaresa rasore ka luajtur të njëjtin rol për ruajtjen e temës së plotë, që është e njëjtë me trajtën e shquar në një kohë kur trajta e pashquar e rasës emërore del me temë të cunuar për shkak të rënies së bashkëtingëllores fundore” (fq. 268).

Pasi në rasën emërore të pashquar (një zë), zanorja hundore mungon, kuptohet se kjo rënie ka ndodhur pas formimit të trajtës së shquar, ku është ruajtur *n*-ja. Të njëjtat ndryshime hasen tek emrat me togun zanor *ua*: *një krua*, *i*, *e një kroi*, ndërsa emërorja e shquar bashkëpërkon për nga forma me dhanoren dhe gjinoren e pashquar. Duke filluar nga Boppi, pastaj edhe nga shumë gjuhëtarë të tjerë, mbaresat e këtyre rasave shihen të trashëguara. Sipas tyre, mbaresa *i* është nxjerrë nga diftongu *-ei*, kurse mbaresa *e* është nxjerrë nga *-ai*.

Por, shumë gjuhëtarë nuk e kanë mbështetur këtë mendim si: Petar Skoku (1926:171) sipas të cilit, këto mbaresat nuk janë të trashëguara, por rrjedhin nga forma përemërore, teze të cilën e ka zhvilluar Bokshi, që thotë se sistemi i vjetër rasor është zhdukur para depërtimit të huazimeve të vjetra nga greqishtja e latinishtja, e sistemi rasor është krijuar pas aglutinimit të nyjës shquese. Sipas Topallit, (fq. 270) nga këto mbaresat, vetëm zanorja *e* (mbaresë e gjinore-dhanores së emrave femërorë), mund të dalë nga një mbaresë e trashëguar, saktësisht nga mbaresat *-ias* e kësaj rase, ku fërkimorja në pozicion fundor ka rënë, ndërsa gjysmëzanorja *i* ka ndikuar në zhvillimin e zanores *a* që nuk ka dhënë *ë* si në rasën emërore (fushë), por ka dhënë *e* (fushe).

Ai e sheh këtë sistem pjesërisht të trashëguar, e në një pjesë si zhvillim të brendshëm, të riformuar. Kjo, siç thotë ai, gjen mbështetje edhe në faktin që format e reja rasore të gjinisë mashkullore nuk u krijuan me rrugë analitike, por sipas modelit të vjetër, domethënë, duke e ruajtur karakterin sintetik. Formën e gjinisë mashkullore *-it* (fq. 282), Topalli e sheh të krijuar mjaft herët në gjuhën shqipe, për shkak të pranisë së emrave me mbaresë të tillë në dokumentet më të vjetra (*atit, birit*).

Sa u përket këtyre hipotezave, që do të mbeten gjithmonë të tilla për shkak të mungesës së burimeve, megjithëse është ruajtur karakteri sintetik, mendojmë se gjasat më të mëdha janë të kenë rënë në një kohë mjetet rasore burimore, sepse ndryshojnë mjaft shumë fonologjikisht, edhe pse disa shpjegime të dhëna nga Topalli e Demiraj (2002) janë të arsyeshme shkencërisht. Gjithashtu, mund ta shtojmë si argument edhe veprimin e fuqishëm të theksit dinamik si dhe zhvillimin e brendshëm të sistemit të lakimit.

## 6. Rasa rrjedhore (përfundimet)

Rasa rrjedhore paraqitet mjaft problematike në gjuhën shqipe për shkak të homonimisë me rasat e tjera të zhdrejta, përdorimit jo shumë të shpeshtë dhe përzierjes së funksioneve me rasën dhanore. Elementi i trashëguar që ka shërbyer si bazë e mbijetesës së saj si rasë e veçantë është mbaresa *-sh* në shumësin e pashquar si dhe disa funksione sintaksore. Në gjuhën indoevropiane, mendohet se ka pasur mbaresa të veçanta, me të cilat dallohej nga rasat e tjera *-es, -os, -s, -ed*. Në shqipe, ajo dallohet nga rasat e tjera në shumësin e pashquar me mbaresën e vetme *sh*, që nuk sjell dallime në gjini, pra në të dyja del njësoj.<sup>34</sup>

Ndërsa, në trajtën e pashquar të numrit njëjës dallohet sipas gjinisë: emrat mashkullorë kanë mbaresën *-i* (*-u* në kushte të caktuara) *një mali*, kurse emrat femërorë kanë mbaresën *-e*, ashtu si në gjinore e dhanore. Sipas Topallit, (fq.293), rrjedhja në sistemin e lakimit të shqipes del pjesërisht e trashëguar. Ai, mbaresën e numrit shumës e sheh të trashëguar prej mbaresës së rasës vendore (lokativit) që ka qenë *-su*. Kjo mbaresë, sipas tij, me rënien e zanores së shkurtër dhe shndërrimin e fërkimoreve alveolare në qiellzore alveolare ka dhënë mbaresën *sh*, ku rasa rrjedhore e ka marrë funksionin e rasës vendore.

Në fund të monografisë (fq. 333-336), Topalli jep edhe përfundimet e nxjerra, ku mbaresat *e, i, sh* sheh të trashëguara, gjë që e bën shqipen të mos i ketë humbur lidhjet me sistemin rasor indoevropian, d.m.th. me karakter sintetik. Sipas tij, fundorja *ë* e emrave femërorë është vijim i mbaresës së trashëguar *-á* të gjatë dhe fundorja e emrave femërorë është vijim i mbaresës *-ias*, ndërsa *ë-në* e emrave mashkullorë dhe asnjans (gjumë, lëmë, drithë, grurë), ashtu si Demiraj (2002) e sheh të ardhur nga *-om*, e *-sh-në* e rrjedhore, nga *-su* e vendore. Me rol drejtues a udhëheqës siç e pamë, ai i sheh mbaresat e trashëguara të gjinisë femërore, ndërsa ato mashkullore kanë ndjekur rrugë analogjike me nyjat shquese, me model gjininë femërore.<sup>35</sup> Ai vë theksin edhe te thjeshtimi e sinkretizmi që i ka prekur paradigmat e lakimit të emrave.

<sup>34</sup> Te disa emra del edhe anaptiksi *i* për lehtësi shqiptimi, për shkak të takimit të bashkëtingëlloreve (bujqish) ose tek emrat me temë trokaike, që lehtëson shqiptimin e një grupi bashkëtingëllor që përmban qiellzore: *nxënisish, mësuësish*.

<sup>35</sup> Sipas Topallit (2009:334) mbaresa rasore *-e* është identike me një shquese më të vjetër të gjinisë mashkullore.

## 7. Përfundimi

Megjithëse shumë çështjeve është vështirë t'u jepet përgjigje me bindje të plotë, qëndrimet e Topallit ndaj fenomeneve kanë gjetur mbështetje shkencore, por, siç e pamë, ka pasur edhe mospajtime në disa qasje ndaj problemeve në sistemin rasor. Ky sistem ka pësuar lëvizje të vazhdueshme dhe vendimtarë për arritjen e formave të sotme dhe në lëvizjen e strukturave, pa dyshim se janë faktorët fonologjikë, ndjekja e analogjisë, diferencat e veçorive të fonemave, ndeshja mes tyre, kur gjenden afër njëra-tjetrës, si dhe nevoja për t'i qartësuar e dalluar rasat për nga struktura e fjalës. Sipas Topallit, sistemi rasor i emrave ka bërë ndryshime të mëdha krahasuar me sistemin e vjetër indoevropian dhe është pjesërisht i trashëguar e i riformuar dhe procesi i thjeshtimit e i sinkretizmit ka prekur edhe paradigmat e lakimit të emrave, duke u reduktuar edhe paradigma e gjinisë asnjansë, gjë që ka çuar në zhdukjen graduale të kësaj gjinie në shqipe.

Mbaresat e emrave, që ia japin kuptimin gramatikor fjalës, në shqipe paraqiten mjaft komplekse dhe vështirë të zgjidhshme sa i përket mënyrës së përfuturit, pavarësisht se a janë të trashëguara apo jo. Pamundësia për të gjetur shpjegim konkret për rasat buron edhe nga dukuritë e pavërejtshme shkencërisht gjatë rrjedhës së kohës. Megjithëse ka pamundësi për të gjetur një shpjegim konkret, Topalli ka dhënë hipoteza të arsyeshme dhe relevante për hulumtim të mëtejshëm.

## Referencat

- [1]. Bokshi, B. (1980). *Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes*. Prishtinë: ASHAK.
- [2]. Bokshi, B. (2010). *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*. Prishtinë: ASHAK.
- [3]. Demiraj, Sh. (1989). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Prishtinë: Rilindja.
- [4]. Demiraj, Sh. (2002). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe (botim i përmbledhur)*. Tiranë : ASHAK.
- [5]. Jokl, N. (1915). *Beitrage zur alb. Grammatik 3: Der Akkusativ-Nominativ*, IF 36, Leipzig.
- [6]. Pedersen, H. (1905). *Albanesisch* Rom.Jb: Erlange.
- [7]. Skok, P. (1926). *Considerations generals sur la declinaison nominale roumanio-albanese*. Arhiv III
- [8]. Riza, S. (2002). *Dëftorët e shqipes dhe historiani i tyre*. Ribotuar në Vepra III. Prishtinë: ASHAK.
- [9]. Topalli, K. (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë: Plejad.